



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

**PËR DHËNIEN E SHPËRBLIMIT TË FUNDVITIT NË MASËN 5.000 (PESË MIJË)
LEKË NGA FONDI I DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL TË BASHKISË BERAT
PËR FAMILJET/INDIVIDËT E MUAJIT
NËNTOR 2025.**

Të nderuar këshilltarë ,

Komisini i Ekonomis, Taksave, DSHS në mbledhjen e datës _____.____.2025, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 8/2, 9 pika 1.1, gërma “b”, 21, 64 gërma “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar datë 29.12.2021, kreu IV, pika 1, 2, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe VKM nr.8 datë 14.01.2015 i ndryshuar në datë 15.01.2019 “Për mbrojtjen e Shtresave në Nevojë, për efekt të heqjes së Fashës së Kompesimit të Energjisë Elektrike deri në 300 këh në muaj” , VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, VKM-së nr._____, datë ____/____/2025.

VENDOSI :

Përfitojnë shpërblimin e fundvitit në masën 5.000 (pesë mijë) lekë nga fondi i drejtorisë së shërbimit social të bashkisë Berat për familjet/individët që trajtohen me ndihmë ekonomike në muajin Nëntor 2025, **59 familje/individ në shumën 295.000 (dyqind e nëntë dhjetë e pesë mijë) lekë.**

TË MOS TRAJTOHEN ME SHPËRBLIM FAMILJET/INDIVIDËT :

- Të cilët kanë përfituar nga VKM dhe Vendimet respektive të dala nga qeveria Shqipëtare për mbështetjen e familjeve/individëve në nevojë, kjo bazuar në verifikimet e bëra nga administratorët shoqëror në qytet dhe njësitë administrative.

7

Bashkëngjitur gjeni listen e familjeve/individët përfitues.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA



Komisioni i Ekonomisë, Taksave, DSHS: ____ Vota Pro, ____ Vota Kundër, ____ Vota Abstenim